

Organizata Shqiptare e Urdhrit të Maltës ka vendosur që nxënësve të klasës së 9-të të shkollës “Liri” t’u bëjë një dhuratë, një udhëtim edukues/historik në Kosovë, në Gjakovë dhe Prizren.

Këta nxënës janë pjesë e shërbimeve që Malteser ofron për Komunitetin Rom dhe Egjiptian në Shkodër.

Udhëtimi është zhvilluar më 3 qershor dhe nxënësit janë shoqëruar nga drejtori i shkollës, mësuesja kujdestare dhe mësues të tjerë. Ndër të tjera, ata kanë vizituar Shtëpinë e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit dhe Muzeun Historik.

